



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref:1705/407/BA/AH

BORDI PËR ANKESA, i përbërë nga Avdyl Hyseni, kryetar dhe Dua Dauti-Kadriu e Musa Dragusha anëtarë, lidhur me ankesën e parashtruar nga Arben Visoqi, rr. Qëndresa nr 64, fshati Llukac i Begut, KK Istog, kundër Vendimit Ref:1611/1243/KPM/am, të datës 25.11.2016 të Komisionit të Pavarur për Media, me datën 18.04.2017, mori këtë:

V E N D I M

APROVOHET ankesa si e bazuar e Arben Visoqi, rr. Qëndresa nr 64, fshati Llukac i Begut, KK Istog, Shfuqizohet Vendimi Ref:1611/1243/KPM/am, i datës 25.11.2016 së Komisionit të Pavarur për Media, dhe lënda kthehet në rishqyrtim.

A r s y e t i m

Arben Visoqi, me date 29.11.2016 ka parashtruar ankesë kundër Vendimit Ref:1610/1047/KPM/am, i datës 11.10.2016 së Komisionit të Pavarur për Media, pran Bordit për Ankesa.

Bardi për Ankesa, në seancën e mbajtur me date 18.04.2017, ka shqyrtuar ankesën e Arben Visoqit, kundër Vendimit Ref:1610/1047/KPM/am, i datës 11.10.2016 së Komisionit të Pavarur për Media, me të cilin ka refuzuar ankesën e Arben Visoqit.

Arben Visoqi, konsideron se Vendimi i KPM-së, lidhur me ankesën time është marrë me baze ligjore të gabuar, është përdorë Kodi i Etikës KKPM 2016/03, në vend që të përdoret Kodi i Etikës KKPM 2010/1, sepse kronika ofenduese e RTV Dukagjini, dhe paraqitja e ankesës ka ndodhur para se të hyje në fuqi Kodi i Etikës, në të cilin është thirrë në vendim KPM-ja. Gjithashtu konsideron se vendimi i KPM-se, është marrë pa i shqyrtuar faktet sepse RTV Dukagjini, me date 08 shtator 2016, përkatësisht gazetari z. Arben Ahmeti në emisionin zyra e ankesave ka ofenduar fëmijët e dëshmorëve dhe veteraneve, si dhe politikën e Ministrisë së Shëndetësisë, ku në baze të Udhëzimit Administrativ jepen nga 5 pike extra për këto dy kategori në konkursin për specializim. z. Ahmeti përveç që përdorë gjuhën nënçmuese, tallet dhe i vene në pozitë denigruese dhe të pa favorshme këto dy kategori.

Përfaqësuesi i KPM-se, deklaroi se vendimi i KPM-së, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe aktet tjera nënligjore. Aplikimin e dispozitave të Kodit të Etikës KKPM 2016/03, KPM e ka marrë për bazë sepse vendimi është marrë pasi ka hyrë në fuqi Kodi i Etikës KKPM 2016/03, dhe palën ankuese nuk e venë në pozitë me të ultë juridike në raport me Kodin e Etikës 2010/01. Sa i përket palës ankuese se RTV Dukagjini për rastin në fjale ka shkelur Kodin e Etikës, nuk

qëndron ky pretendim, sepse KPM, gjatë marrjes së Vendimit ka analizuar të gjitha faktet dhe ka konstatuar se RTV Dukagjini nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

Bordi për Ankesa, ka analizuar të gjitha provat dhe gjen se KPM, gjatë marrjes së Vendimit Ref:1611/1243/KPM/am, të datës 25.11.2016, ka aplikuar gabimisht dispozitat e Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, në vend se të përdoren dispozitat e Kodit të Etikës KKPM 2010/01, sepse kronika e RTV Dukagjini, është transmetuar gjatë kohës sa ka qenë në fuqi ky Kod, andaj KPM gjatë rishqyrtimit të ankesës duhet të merr për bazë këtë çështje. Bordi ka analizuar kroniken e RTV Dukagjini të datës 08 shtator 2016, dhe konstaton se gjate kësaj kronike, nuk janë fyer fëmijët e dëshmorëve dhe veteranëve apo edhe politikat e Ministrisë së Shëndetësisë, siç pretendon pala ankuese, por konsideron se është shprehur një mendim nga ana e gazetarit z. Arben Ahmeti, gjatë emisionit sa i përket politikave të Ministrisë.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 36 paragrafi 3 i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, vendosi unanimisht si në dispozitivin të këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi mund të iniciohet konflikt administrative me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.



Avdyl Hyseni
[Signature]
Kryetar i Bordit për Ankesa